



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PRRENJAS

Nr. \_\_\_\_ prot.

Prrenjas, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

[Data01/07/2024]

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “ERZENI/SH”, Shpk me nipt J66902027T me adresë: SHKODER Lagjja Bahçallek, Rruga Nacionale Shkoder-Tirane, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591, me administrator Z. Artor Lesha.

**Procedura e prokurimit/lotit:** Procedure e hapur e thjeshtuar - mall

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** REF-07286-05-30-2024

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Blerje paisje mobilerie per shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm”

**Fondi limit total:** 3,263,297 (tre milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë ) lekë pa TVSH.

**Afati kontrates:** 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës .

**Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):** Buletini i Njoftimeve Publike [Nr.29 date 03.06.2024].

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Bajro Bros”shpk

M113130290

Vlera 2,177,410 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dhjetë ) leke pa tvsh.

2. Operatori ekonomik “BOLT”shpk

K91517011V

Vlera 2,532,500 (dy milion e peseqind e tridhjetë e dy mijë e peseqind) lekë pa tvsh.

3. Operatori ekonomik “Eduart Xhixha”, PF

L54424205B

Vlera : 2,364,400 (dy milion e treqind e e gjashtedhjetë e kater mijë e katerqind) lekë pa tvsh.

4. Operatori ekonomik “ERALD”, Shpk

J74517205P

Vlera : 2,365,000 (dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë)lekë pa tvsh.

5. Operatori ekonomik “ERZENI/SH”, Shpk

J66902027T

Vlera : 2,022,770(dy milion e njezet e dy mije e shtateqind e shtatedhjete) lekë pa tvsh.

6. Operatori ekonomik “KLAME”, Shpk

K21518003F

Vlera : 2,656,099 (dy milion e gjashteqind e pesedhjete e gjashte mije e nentedhjete e nente) lekë pa tvsh.

7. Operatori ekonomik “SHAGA”, Shpk

J96822229J

Vlera : 2,344,040 (dy milion e treqind e dyzete e kater mije e dyzete) lekë pa tvsh.

### **- Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori ekonomik “Bajro Bros”shpk

M11313029O

Vlera 2,177,410 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dhjetë ) leke pa tvsh.

Arsyet e mëposhtme :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se :

- Nuk i plotëson kriteret e vecanta për kualifikim.

Konkretisht :

1.1 OE “Bajro Bros”, Shpk me nipt M11313029O nuk ka arritur te paraqese dokumentacionin e saktë kerkuar sipas pikes 1/b Kriteret e vecanta te kualifikimit.

Konkretisht nuk ka bere sakte vleren e sigurimit te ofertes sa 2% te fondit limit.

Operatori Ekonomik ka paraqitur Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3, por shuma e sigurimit të ofertës nuk është sipas percaktimeve te DST sa 2% te fondit limit 65,266 leke.

Shuma e sigurimit të ofertës është me pak se sa eshte kerkuar , konkretisht 47,400 < 65,266.

Në nenin 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar parashikohet shprehimisht se :

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “Bajro Bros” Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.

2. Operatori ekonomik “KLAME” Shpk

K21518003F

Vlera : 2,656,099 (dy milion e gjashteqind e pesedhjete e gjashte mije e nentedhjete e nente) lekë pa tvsh.

Arsyet e mëposhtme :

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se :

- Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

Konkretisht :

1.1 OE “KLAME”, Shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacionin e saktë të kerkuar sipas pikes

2.3.1 Kapacitetet teknike te kualifikimit ku është kërkuar :

**2.3.1** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më te vogël se 20% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

a. *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqitet kontrata e lidhur e shoqëruar me vërtetimin përkatës të lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kontratës.*

**Ose**

b. *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Përsa i përket përvojës së mëparshme me sektorin publik OE “KLAME” Shpk ka paraqitur vërtetime realizimi + faturat per kontratat me objekte :

- ”Blerje pajisje mobilerie shkolla e Mesme Skenderbeu Krume” me Bashkinë Has

- ”Blerje pajisje mobilerie shkolla fillore ”Myrteza Sala” Bilisht,Devoll” me Bashkinë Devoll

- ”Pajisje mobilerie per shkollat e arsimit te mesem te pergjithshem Shkolla Avni Rustemi dhe Shkolla Havzi Nela Kukes” me Bashkinë Kukes, referuar kriterëve te kualifikimit te percaktuara ne DST dokumentacioni i paraqitur nuk eshte i plote, pasi jane paraqitur vetem vërtetimet e realizimit dhe faturat perkatese ndersa kontratat e nenshkruara nuk jane paraqitur.

*Në nenin 92 pika 3 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndyrshuar parashikohet shprehimisht se :*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të nenit 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje te nenit 77, 87,92 të Ligjit 162/2020, “Për Prokurimin publik”i ndryshuar si dhe Dokumentave Standarde të Tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “KLAME”, Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të pavlefshme.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “ERZENI/SH” Shpk me nipt J66902027T me adresë: SHKODER Lagjja Bahçallek, Rruga Nacionale Shkoder-Tirane, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591, me administrator Z. Artor Lesha, me ofertë ekonomike 2,022,770 (dy milion e njezet e dy mije e shtateqind e shtatedhjetë) lekë pa tvsh dhe 2,427,324 (dy milion e katerqind e njezet e shtate mije e treqind e njezet e kater) lekë me tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme e procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Prrenjas, Rruga Skenderbej, Sektori Juridik dhe i prokurimeve] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 2,344,040 (dy milion e treqind e dyzet e kater mije e dyzet) lekë pa tvsh, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Pranoi: Z. Çekrezi

Konceptoi: M.Rira  
A.Kopaçi

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**NURI BELBA**